Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

PROJEKTLIGJI KUNDËR DUKURIVE NEGATIVE NË SPORT[1]

DRAFT LAW AGAINST NEGATIVE PHENOMENA IN SPORTS[2]

NACRT ZAKONA PROTIV NEGATIVNIH POJAVA U SPORTU[3]

---

[1] Projektligji Kundër Dukurive Negative në Sport, është aprovuar në mbledhjen e 11, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendimin nr.13/11, të datës, 16.11.2026;

[2] Draft Law Against Negative Phenomena in Sports, haas been in the 11, metting of the Government of the Republic of Kosovo, with the Decision, No.13/11, dated 16.11.2026;

[3] Nacrt zakona Protiv Negativnih Pojava u Sportu, usvojeno na 11, Sednici Vlade, sa Odlukom Br.13/11, datum 16.11.2026.

Kuvendi i Republikës së Kosovës,	**The Assembly of the Republic of Kosovo,**	**Skupština Republike Kosova,**
Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,	Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo,	Na osnovu člana 65. (1) Ustava Republike Kosovo,
Miraton:	Adopts:	Usvaja:
LIGJ KUNDËR DUKURIVE NEGATIVE NË SPORT	**LAW AGAINST NEGATIVE PHENOMENA IN SPORTS**	**ZAKON PROTIV NEGATIVNIH POJAVA U SPORTU**
KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	**CHAPTER I GENERAL PROVISIONS**	**POGLAVLJE I OPŠTE ODREDBE**
Neni 1 Qëllimi	**Article 1 Purpose**	**Član 1 Cilj**
Ky ligj ka për qëllim zhvillimin e sportit dhe organizimin e ngjarjeve sportive në një ambient sportiv të sigurt, të barabartë për të gjithë, dhe të lirë nga dhuna dhe dukuri tjera negative, duke ofruar standarde të larta të rendit, sigurisë dhe shërbimeve në ngjarjet sportive, si dhe zhvillimin dhe promovimin e këtyre	This law is aimed at the development of sports and the organization of sports events in a safe sports environment, equal for all and free of violence and other negative phenomena, offering high standards of safety, security and services in sports events, as well as the development and promotion of these standards in accordance	Ovaj zakon ima za cilj razvoj sporta i organizovanje sportskih događaja u u bezbednom sportskom okruženju, jednakom za sve, bez nasilja i drugih negativnih pojava, pružajući visoke standarde reda, bezbednosti i usluga na sportskim događajima, kao i razvoj i promovisanje ovih standarda u skladu sa

standardeve në përputhje me vlerat qenësore dhe parimet e sportit.	with the inherent values and principles of sport.	inherentnim vrednostima i principima sporta.
Neni 2 **Fushëveprimi**	**Article 2** **Scope**	**Član 2** **Delokrug**
Ky ligj zbatohet për të gjithë sportistët dhe pjesëmarrësit në sport dhe institucionet apo organizatat e tjera të përmendura shprehimisht në këtë ligj, përfshirë personat fizikë.	This law shall apply to all participants in sports and other institutions or organizations expressly mentioned in this law, including natural persons.	Ovaj zakon se primenjuje na sve sportiste i učesnike u sportu i drugim institucijama ili organizacijama izričito pomenutim u ovom zakonu, uključujući i fizička lica.
Neni 3 **Përkufizimet**	**Article 3** **Definitions**	**Član 3** **Definicije**
1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:	1. Terms used in this law shall have the following meanings:	1. Izrazi koji se koriste u ovom zakonu imaju sledeća značenja:
1.1. **Ngacmim dhe abuzim** – çdo formë e ngacmimit dhe abuzimit, duke përfshirë abuzimin psikologjik, fizik, seksual, ngacmimin seksual apo neglizhencën ndaj një sportisti apo pjesëmarrësi tjetër fizik në sport. Ngacmimi dhe abuzimi mund të ndodhin si forma të vetme apo të kombinuara;	1.1. **Harassment and abuse** – any form of harassment and abuse, including psychological abuse, physical abuse, sexual abuse, sexual harassment, or neglect of an athlete or any other physical participant in sports. Harassment and abuse may occur as single or combined forms;	1.1. **Uznemiravanje i zlostavljanje** – svaki oblik uznemiravanja i zlostavljanja, uključujući psihičko, fizičko, seksualno zlostavljanje, seksualno uznemiravanje ili zanemarivanje sportiste ili drugog fizičkog učesnika u sportu. Uznemiravanje i zlostavljanje se mogu javiti kao pojedinačni ili kombinovani oblici;
1.2. **Abuzim psikologjik** – çdo veprim i padëshiruar duke përfshirë mbylljen, izolimin, sulmin verbal, poshtërimin,	1.2. **Psychological abuse** – any unwanted action, including isolation, confinement, verbal assault, humiliation,	1.2. **Psihološko zlostavljanje** – bilo koji neželjeni čin uključujući zatvaranje, izolaciju, verbalni napad,

frikësimin, fëmijërizimin ose çdo formë tjetër që mund të dëmtoj identitetin, dinjitetin apo vlerësimin për vete të personit;	intimidation, infantilization, or any other form that may harm a person's identity, dignity, or self-esteem;	ponižavanje, zastrašivanje, detinjastost ili bilo koji drugi oblik koji može naštetiti identitetu, dostojanstvu ili samopoštovanju osobe;
1.3. **Abuzim fizik** – çdo veprim i dhunshëm dhe i padëshirueshëm, siç është për shembull grushtimi, rrahja, shkelmimi, kafshimi dhe djegia, që shkakton traumë fizike ose lëndim. Këtu përfshihen edhe rastet e trajnimit apo aktivitetit fizik të detyruar apo të papërshtatshëm, siç është ngarkesa në trajnim kur sportisti është i lënduar apo me dhimbje, detyrimi i konsumimit të alkooholit apo praktikave të detyruara të dopingut;	1.3. **Physical abuse** – any violent and unwanted action, such as punching, beating, kicking, biting, and burning, that causes physical trauma or injury. This also includes cases of forced or inappropriate training or physical activity, such as excessive training when the athlete is injured or in pain, forced consumption of alcohol, or coerced doping practices;	1.3. **Fizičko zlostavljanje** – svaka nasilna i neželjena radnja, kao što su udaranje, premlaćivanje, šutiranjr, ujedanje i paljenje, koja uzrokuje fizičku traumu ili povredu. Ovo takođe uključuje slučajeve prinudnog ili neodgovarajućeg treninga ili fizičke aktivnosti, kao što je opterećenje prilikom treninga kada je sportista povređen ili ima bol, primoran da konzumira alkohol ili prinudne doping prakse;
1.4. **Abuzim seksual** – çdo sjellje e natyrës seksuale, qoftë jo prekëse, prekëse apo penetruese, ku pëlqimi është i detyruar, manipulohet ose nuk është dhënë apo nuk mund të jepet;	1.4. **Sexual abuse** - any conduct of a sexual nature, whether non-contact, contact or penetrative, where consent is coerced, manipulated or is not or cannot be given;	1.4. **Seksualno zlostavljanje** – svako ponašanje seksualne prirode, bilo bez kontakta, sa kontaktom ili prodorom, gde je pristanak iznuđen, izmanipulisan ili nije dat ili ne može biti dat;
1.5. **Bast sportiv** – çdo vendosje e aksionit ose e vlerës monetare në pritje të një çmimi me vlerë monetare, subjekt i një dukurie të ardhshme dhe të pasigurt lidhur me një garë sportive;	1.5. **Sports betting** – any placing of a stake or monetary wager in the expectation of making a profit, subject to a future and uncertain event related to a sports competition;	1.5. **Sportsko klađenje** - svako postavljanje uloga ili monetarne vrednosti u iščekivanju neke nagrade sa monetarnom vrednošću, subjekt buduće i nebezbednosne pojave u vezi sa sportskim takmičenjem;

1.6. **Diskriminim** – trajtim më pak i favorshëm i një sportisti apo pjesëmarrësi tjetër në sport krahasuar me personat tjerë në një situatë të krahasueshme, bazuar në një ose më shumë kritere që nuk janë të ligjshme ose legjitime, duke përfshirë këtu edhe përzgjedhjen e sportiestëve për përfaqësim në gara sportive ndërkombëtare;	1.6. **Discrimination** – less favorable treatment of an athlete or another participant in sports compared to other persons in a comparable situation, based on one or more criteria that are not lawful or legitimate, including the selection of athletes for representation in international sports competitions;	1.6. **Diskriminacija** – nepovoljniji tretman sportiste ili drugog učesnika u sportu u odnosu na druga lica u uporedivoj situaciji, na osnovu jednog ili više kriterijuma koji nisu legalni ili legitimni, uključujući izbor sportista za predstavljanje na međunarodnim sportskim takmičenjima;
1.7. **Kurdisje e ngjarjes sportive** – marrëveshje, veprim ose mosveprim që ka për qëllim ndryshimin jo të drejtë të rezultatit ose drejtimit të garës sportive, në mënyrë që të largohet natyra e paparashikueshme e garës sportive të lartpërmendur, në tërësi apo pjesërisht, duke synuar përfitimin e padrejtë për veten ose personat e tjerë;	1.7. **Sports event fixing** – an agreement, action, or omission intended to unfairly alter the outcome or course of a sports competition in order to remove all or part of the unpredictable nature of the aforementioned sports competition with a view to obtaining an undue advantage for oneself or others;	1.7. **Nameštanje sportskog događaja** - dogovor, radnja ili neradnja koja ima za cilj nepravednu promenu rezultata ili pravca sportskog takmičenja, kako bi se u celosti ili delimično otklonila nepredvidiva priroda gorenavedenog sportskog takmičenja, nameravajući nepravednu korist za sebe ili druga lica;
1.8. **Masat e rendit** – çdo masë e synuar dhe zbatuar me qëllim kryesor të mbrojtjes shëndetit dhe mirëqenies së individëve dhe grupeve që janë të pranishëm ose marrin pjesë në një ngjarje sportive, brenda ose jashtë objektit sportiv, ose të cilët banojnë apo punojnë në afërsi të ngjarjes;	1.8. **Safety measures –** any measure intended and implemented with the main purpose of protecting order, peace and public safety, health and well-being of individuals and groups who are present, or participate, in a sports event, inside or outside the sports facility, or who live or work in the vicinity of the event;	1.8.**Mere reda** - svaka mera namenjena i sprovedena sa osnovnom svrhom zaštite zdravlja i dobrobiti pojedinaca i grupa koji su prisutni ili učestvuju na sportskom događaju, unutar ili van sportskog objekta, ili koji žive ili rade u blizini;
1.9.**Masat e sigurisë** – çdo masë e synuar dhe zbatuar me qëllim kryesor të parandalimit të incidenteve, zvogëlimit	1.9. **Security measures -** any measure intended and implemented with the main purpose of preventing incidents, reducing	1.9. **Bezbednosne mere** - svaka mera nameravana i sprovedena sa glavnim ciljem sprečavanja incidenata,

të rrezikut dhe reagimit ndaj çdo dhune ose veprimi kriminal ose prishje të rendit dhe qetësisë publike të kryer lidhur me ngjarjen sportive, brenda apo jashtë objektit sportiv;	potential risk and responding to any violence or criminal act or disruption of public order and peace, carried out in connection with the sports event, inside or outside the sports facility;	smanjenja rizika i reagovanja na svako nasilje ili krivično delo ili narušavanje javnog reda i mira koja se sprovodi u vezi sa sportskim događajem, unutar ili van sportskog objekta;
1.10. **Masat e shërbimeve** – çdo masë e synuar dhe zbatuar me qëllim kryesor që individët dhe grupet të ndihen mirë, të vlerësuar dhe mirëpritur, kur marrin pjesë në një ngjarje sportive, brenda apo jashtë objektit sportiv;	1.10.**Service measures** – any measure that is implemented and intended to make individuals and groups feel good, valued and welcome when they are present at a sports event, inside or outside the sports facility;	1.10. **Mere usluga** - svaka mera koja je predviđena i sprovedena sa glavnom svrhom da se pojedinci i grupe osećaju dobro, cenjeno i dobrodošlo, kada učestvuju u sportskom događaju, unutar ili van sportskog objekta;
1.11.**Ngacmimi seksual** – çdo sjellje verbale, jo verbale ose fizike e natyrës seksuale, që është e padëshirueshme;	1.11. **Sexual harassment** – any verbal, non-verbal or physical behavior of a sexual nature that is unwanted and unwelcome;	1.11. **Seksualno uznemiravanje** – svako verbalno, neverbalno ili fizičko ponašanje seksualne prirode koje je neželjeno;
1.12.**Neglizhencë** – dështimi i një trajneri, instruktori apo një personi tjetër që ka për detyrë të kujdeset për sportistin, të ofroj një nivel minimal të kujdesit për të, duke i shkaktuar dëm, lejuar që dëmi të shkaktohet, apo krijuar rrezikun për shkaktimin e dëmit.	1.12. **Negligence** – the failure of a coach, instructor, or other responsible person to provide an adequate level of care for an athlete, leading to harm, allowing harm to occur, or creating a risk of harm.	1.12. **Nepažnja** – propust trenera, instruktora ili drugog lica koje je dužno da brine o sportisti, da mu pruži minimalni nivo pažnje, nanošenje štete, dozvoljavanje nanošenja štete ili stvaranje rizika od nanošenja štete.
2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e njëjtë si shprehjet e përdorura në ligjin në fuqi për sport.	2. Other terms used in this law shall have the same meaning as the terms used in the applicable law on sports.	2. Ostali izrazi korišćeni u ovom zakonu imaju isto značenje kao izrazi korišćeni u zakonu na snazi o sportu.
KAPITULLI II	**CHAPTER II**	**POGLAVLJE II**

KOORDINIMI NË NIVEL KOMBËTAR	COORDINATION AT THE NATIONAL LEVEL	KOORDINACIJA NA NACIONALNOM NIVOU
Neni 4 **Këshilli Kombëtar Kundër Dukurive Negative në Sport**	**Article 4** **National Council Against Negative Phenomena in Sports**	**Član 4** **Nacionalni savet protiv negativnih pojava u sportu**
1. Këshilli Kombëtar Kundër Dukurive Negative në Sport (në tekstin e mëtejmë: Këshilli) është trupë koordinuese që ka për qëllim koordinim e përgjithshëm të masave parandaluese, operative dhe sanksionuese kundër dukurive negative në sport.	1. National Council Against Negative Phenomena in Sports (hereinafter referred to as the Council) shall be a coordinating body established by the decision of the Government of the Republic of Kosovo, to generally supervise the undertaking of preventive, operational and sanctioning measures against violence and other negative phenomena in sports.	1. Nacionalni savet protiv negativnih pojava u sportu (u daljem tekstu: Savet) je koordinaciono telo čija je svrha opšta koordinacija preventivnih, operativnih i sankcionišućih mera protiv negativnih pojava u sportu.
2. Këshilli emërohet nga Ministri përgjegjës për Sport dhe përbëhet nga përfaqësues institucionalë dhe të sektorit të sportit, nga institucionet dhe organizatat si në vijim:	2. The Council shall consist of institutional and sports sector representatives, from the following institutions and organizations:	2. Savet imenuje ministar nadležan za sport i čine ga predstavnici institucija i sektora sporta iz sledećih institucija i organizacija:
2.1. një (1) përfaqësues prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;	2.1. one (1) prosecutor representative from the Office of the Chief State Prosecutor;	2.1. jedan (1) predstavnik tužilac iz Kancelarije Glavnog državnog tužioca;
2.2. një (1) përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Sport apo Agjencia e Sportit në kuadër të Ministrisë;	2.2. one (1) representative from the Ministry responsible for Sports or the Sports Agency within the Ministry;	2.2. jedan (1) predstavnik Ministarstva nadležnog za sport ili Agencije za sport u okviru Ministarstva;

2.3. një (1) përfaqësues gjyqtar caktuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës;	2.3. one (1) judge representative appointed by the Kosovo Judicial Council;	2.3. jedan (1) predstavnik sudija imenovan od Sudskog saveta Kosova;
2.4. një (1) përfaqësues nga Policia e Kosovës;	2.4. one (1) representative from the Kosovo Police;	2.4. jedan (1) predstavnik iz Policije Kosova;
2.5. një (1) përfaqësues nga Komiteti Olimpik i Kosovës;	2.5. one (1) representative from the Kosovo Olympic Committee;	2.5. jedan (1) predstavnik iz Olimpijskog komiteta Kosova;
2.6. një (1) sportist apo ish sportist nga Shoqata e Sportistëve të Kosovës;	2.6. one (1) athlete or former athlete from the Kosovo Sportsmen's Association;	2.6. jedan (1) sportista ili bivši sportista iz Udruženja sportista Kosova;
2.7. një (1) përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile në fushën e sportit apo ekspert të pavarur në fushën kundër dukurive negative në sport; dhe	2.7. one (1) representative from civil society organizations in the field of sports or an independent expert in the field against negative phenomena in sports; and	2.7. jedan (1) predstavnik organizacija civilnog društva iz oblasti sporta ili nezavisni stručnjak iz oblasti protiv negativnih pojava u sportu; i
2.8. një (1) përfaqësues nga Ministria përkatëse e Pushtetit Lokal.	2.8. one (1) representative from the relevant Ministry of Local Government.	2.8. jedan (1) predstavnik iz nadležnog Ministarstva za lokalnu samoupravu.
3. Anëtarët e përzgjedhur të Këshillit reflektojnë vlerat më të larta të integritetit personal dhe profesional. Personi i sanksionuar për dukuri negative në sport, apo i dënuar për vepër penale përveç atyre nga pakujdesia, apo i pezulluar nga Gjykata për veprimtarinë e vet, nuk mund të jetë pjesë e Këshillit.	3. The selected members of the Council reflect the highest values of personal and professional integrity. A person sanctioned for negative phenomena in sports,or convicted for a criminal offense except for those due to negligence, or suspended by the Court for his activity, cannot be part of the Council.	3. Izabrani članovi Saveta odražavaju najviše vrednosti ličnog i profesionalnog integriteta. Osoba koje je sankcionisano za negativne pojave u sportu, ili osuđeno za krivično delo osim za one iz nehata, ili suspendovano od strane suda zbog svoje delatnosti, ne može biti u sastavu Saveta.

4. Përfaqësuesi nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit është kryesues i Këshillit sipas detyrës zyrtare.	4. The representative from the Office of the Chief State Prosecutor shall be the ex officio chairperson of the Sports Council.	4. Predstavnik Kancelarije glavnog državnog tužioca je po službenoj dužnosti predsedavajući Saveta.
5. Përveç përfaqësuesit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit që shërben sipas detyrës zyrtare në Këshill, anëtarët e tjerë të Këshillit emërohen nga Ministria pas nominimit nga institucionet, përkatësisht nga organizatat përkatëse, apo me aplikim të drejtpërdrejtë të ekspertit të pavarur sipas nën-paragrafit 2.7 të këtij Neni.	5. In addition to the representative of the Office of the Chief State Prosecutor who serves ex officio in the Council, the other members of the Council shall be appointed by the relevant minister of sports after being nominated by the institutions, respectively by the relevant organizations, or by direct application of the independent expert based on sub-paragraph 2.7 of this Article.	5. Pored predstavnika Kancelarije glavnog državnog tužioca koji je u Savetu po službenoj dužnosti, ostale članove Saveta imenuje Ministarstvo nakon nominacije od institucija, odnosno nadležnih organizacija, ili direktnom primenom nezavisnog stručnjaka prema podstavu 2.7 ovog člana.
6. Mandati i anëtarit të Këshillit është katër (4) vite.	6. The mandate of the member of the Council is four (4) years.	6. Mandat člana Saveta traje četiri (4) godine.
7. Me vendim të Këshillit apo sipas sugjerimit të Ministrit përgjegjës për sport, në mbledhje të caktuara të Këshillit mund të ftohen edhe persona tjerë që janë relevant për çështjen që diskutohet nga Këshilli.	7. By decision of the Council or according to the suggestion of the minister responsible for sports, other persons who are relevant to the matter discussed by the Council may be invited to specific meetings of the Council.	7. Odlukom Saveta ili na sugestiju ministra nadležnog za sport, na pojedine sednice Saveta mogu biti pozvani i druge osobe koje su od značaja za materiju o kojoj raspravlja Savet.
8. Përjashtimisht nga nën-paragrafi 2.5 i këtij Neni, për çështjet që trajtohen nga Këshilli lidhur me sportistët apo organizatat që janë anëtarë të Komitetit Paralimpik të Kosovës, Olimpiadës Speciale apo Federatës së Sporteve të të Shurdhërve të Kosovës, në Këshill do të marr pjesë anëtari i kësaj	8. Notwithstanding sub-paragraph 2.5 of this Article, for matters addressed by the Council concerning athletes or organizations that are members of the Paralympic Committee of Kosovo, Special Olympics, or the Kosovo Deaf Sports Federation, the representative of the respective organization/federation shall	8. Sa izuzetkom podstava 2.5 ovog člana, za pitanja koja razmatra Savet u vezi sa sportistima ili organizacijama koje su članice Paraolimpijskog komiteta Kosova, Specijalne olimpijade ili Sportske federacije gluvih Kosova, član ove relevantne organizacije/federacije će

organizate/federate përkatëse, në vend të anëtarit nga Komiteti Olimpik i Kosovës.	participate in the Council instead of the member from the Kosovo Olympic Committee.	učestvovati u Savetu, umesto člana iz Olimpijskog komiteta Kosova.
9. Deri në themelimin e Shoqatës së Sportistëve të Kosovës, përfaqësuesi nga nën-paragrafi 2.6 i këtij Neni, emërohet nga Ministri përgjegjës për Sport.	9. Until the establishment of the Kosovo Sportsmen's Association, the representative mentioned in sub-paragraph 2.6 of this Article shall be appointed by the Minister responsible for Sport.	9. Do osnivanja Udruženja sportista Kosova, predstavnika iz podstava 2.6 ovog člana imenuje ministar nadležan za sport.
10. Mandati i anëtarit të Këshillit ndërpritet:	10. The mandate of a Council member shall be terminated:	10. Mandat člana Saveta prekida se:
10.1. në rast të mospjesëmarrjes për më shumë se dy (2) herë me radhë në mënyrë të paarsyetuar në mbledhjet e Këshillit;	10.1. In the event of consecutive absence for more than two (2) occasions without justification during Council meetings;	10.1. u slučaju neučestvovanja za više od dva (2) puta uzastopno na neopravdan način na sednicama Saveta;
10.2. tërheqjes së nominimit nga institucioni, gjegjësisht organizata përkatëse;	10.2. upon withdrawal of nomination by the institution, namely the relevant organization;	10.2. povlačenje nominacije iz institucije, odnosno odgovarajuće organizacije;
10.3. në rast të sanksionimit për ndonjë nga dukuritë negative në sport sipas këtij ligji; ose	10.3. in case of being sanctioned for any of the negative phenomena in sports according to this law; or	10.3. u slučaju da bude kažnjen za neku od negativnih pojava u sportu po ovom zakonu; ili
10.4. papajtueshmërisë për të qenë pjesë e sportit, siç përcaktohet me ligjin në fuqi për sportin.	10.4. in case of ineligibility for participation in sports, as defined by the law in force on sport.	10.4. neusklađenost da bude deo sporta, kao što se utvrđuje zakonom na snazi o sportu.
11. Agjencia e Sportit në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për Sport shërben në cilësinë e Sekretariatit të Këshillit.	11. The Sports Agency within the Ministry responsible for Sports shall serve as the Secretariat of the Council.	

12. Organizatat e sportit dhe pjesëmarrësit në sport detyrohen të ofrojnë informata dhe të bashkëpunojnë me Këshillin. Në rast të mosbashkëpunimit federata përkatëse dhe Ministria përgjegjëse për Sport ndërmarrin masat përkatëse që mund të përfshijnë edhe ndalimin e financimit për një organizatë ose pjesëmarrës tjetër në sport.	12. Sports organizations and sports participants are obliged to provide information and cooperate with the Council. In the event of non-cooperation, the relevant federation and the Ministry responsible for Sports shall take appropriate measures, which may include the suspension of funding for an organization or sports participants.	11. Agencija za sport u okviru Ministarstva nadležnog za sport služi u svojstvu Sekretarijata Saveta. 12. Sportske organizacije i sportski učesnici obavezuju se pružati informacije i sarađivati sa Savetom. U slučaju nesaradnje, odgovarajuća federacija i Ministarstvo odgovorno za sport preduzimaju odgovarajuće mere, koje mogu uključivati i zabranu finansiranja organizacije ili drugog učesnika u sportu.
13. Këshilli përgatit raporte të rregullta tre (3) mujore për Ministrin përgjegjës për Sport, për zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive sipas këtij Ligji.	13. The Council shall prepare regular quarterly reports for the Minister responsible for Sport on the fulfillment of duties and responsibilities under this Law.	13. Savet priprema redovne tro (3) mesečne izveštaje za ministra nadležnog za sport, o izvršavanju zadataka i odgovornosti prema ovom zakonu.
Neni 5 **Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit**	**Article 5** **Duties and responsibilities of the Council**	**Član 5** **Dužnosti i odgovornosti Saveta**
1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit janë:	1. The duties and responsibilities of the Council are:	1. Dužnosti i odgovornosti Saveta su:
1.1. diskutimi dhe ofrimi i rekomandimeve lidhur me politikat dhe legjislacionin në fushën e parandalimit dhe të sanksionimit të dukurive negative në sport;	1.1. Discussion and provision of recommendations regarding policies and legislation in the field of prevention and sanctioning of violence and other negative phenomena in sports;	1.1. diskusija i pružanje preporuka u vezi sa politikama i zakonodavstvom u oblasti sprečavanja i sankcionisanja negativnih pojava u sportu;
1.2. mbikëqyrja e ngjarjeve dhe e trendeve të dukurive negative në sport;	1.2. supervision of incidents and trends of violence and other negative phenomena in sports;	

1.3. vlerësimi i nevojave dhe i përmbajtjes së masave përjashtuese në sport; 1.4. vlerësimi i efektshmërisë së certifikimit të objekteve sportive, inspektimit dhe aranzhimeve të menaxhimit të masave të rendit dhe sigurisë, si dhe trajnimit të personave të përfshirë; 1.5. promovimi i këtij ligji dhe zhvillimi i planeve mediale dhe të komunikimit me publikun që kanë për qëllim parandalimin dhe eliminimin e dukurive negative në sport. 2.Institucionet dhe organizatat përgjegjëse informojnë Këshillin për masat e ndërmarra për zbatimin e dispozitave të këtij ligji. 3. Për ushtrimin e kompetencave të veta nga ky Nen, Këshilli nxjerr rekomandime të cilat i drejtohen organizatave përkatëse. 4. Çdo herë që Këshilli informohet për ngjarje të dukurive negative në sport, rastin në fjalë e referon, për veprime të mëtutjeshme tek Inspektorati i Sportit apo Prokurori i shtetit, varësisht nga natyra e rastit.	1.3. assessment of the needs and content of exclusionary measures in sports; 1.4. evaluation of the effectiveness of the certification of sports facilities, inspection and safety and security management arrangements, as well as the training of the persons involved; 1.5. development of media and public communication plans aimed at preventing and eliminating violence and other negative phenomena at sports events. 2. The responsible institutions and organizations shall inform the Council about the measures taken to implement the provisions of this law. 3. For the exercise of its competencies from this Article, the Council shall issue recommendations addressed to the relevant organizations. 4. Whenever the Council is informed about negative phenomena in sports, it shall refer the case in question to the Sports Inspectorate or the State Prosecutor for further action, depending on the nature of the case.	1.2. nadzor događaja i trendova negativnih pojava u sportu; 1.3. procena potreba i sadržaja mera isključenja u sportu; 1.4. procena efikasnosti sertifikacije sportskih objekata, inspekcija i aranžmana za upravljanje reda i mera bezbednosti, kao i obuka uključenih lica; 1.5. promovisanje ovog zakona i razvoj medijskih planova i komunikacije sa javnošću u cilju prevencije i otklanjanja negativnih pojava u sportu. 2. Odgovorne institucije i organizacije informišu Savet o preduzetim merama za sprovođenje odredaba ovog zakona. 3. Za vršenje ovlašćenja iz ovog člana Savet daje preporuke upućene relevantnim organizacijama. 4. Svaki put kada Savet bude obavešten o negativnim pojavama u sporskim događajima, predmetni predmet upućuje

5. Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e tjera, kompensimi financiar i Këshillit si dhe aspekte të tjera procedurale rregullohen me akt nënligjor të aprovuar nga Ministri përgjegjës për Sport.	5. Duties, responsibilities, other competencies, financial compensation of the Council as well as other procedural aspects shall be regulated by means of a sub-legal act approved by the relevant minister for sport.	Sportskoj inspekciji ili Državnom tužiocu, u zavisnosti od prirode predmeta, na dalje postupanje. 5. Dužnosti, odgovornosti i druge nadležnosti, finansijska naknada Saveta kao i drugi proceduralni aspekti regulišu se podzakonskim aktom koji donosi ministar nadležan za sport.
Neni 6 **Strategjia për parandalimin dhe sanksionimin e dukurive negative në sport**	**Article 6** **Strategy on the prevention and sanctioning of violence and other negative phenomena in sport**	**Član 6** **Strategija za sprečavanje i sankcionisanje negativnih pojava u sportu**
1.Në bazë të propozimit të Këshillit, Ministri përgjegjës për Sport miraton Strategjinë për parandalimin dhe sanksionimin e dukurive negative në sport. 2.Strategjia nga paragrafi 1 ka për qëllim zbatimin e një qasjeje të integruar të institucioneve dhe organizatave të përfshira drejt parandalimit dhe sanksionimit të dukurive negative në sport, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore në këtë drejtim, si dhe promovimin e dialogut me tifozët, publikun në sport dhe komunitetin në përgjithësi.	1.Based on the proposal of the Council, the minister responsible for sport shall approve the Strategy on the prevention and sanctioning of violence and other negative phenomena in sport. 2.The strategy from paragraph 1 shall aim the implementation of an integrated approach of the institutions and organizations involved in the prevention and sanctioning of violence and other negative phenomena in sports, the development and sustainability of human and infrastructural capacities in this regard, as well as the promotion of dialogue with fans, the public in sports and the community in general.	1.Na osnovu predloga Saveta, ministar nadležan za sport usvaja Strategiju za sprečavanje i sankcionisanje negativnih pojava u sportu. 2. Strategija iz stava 1. ima za cilj sprovođenje integrisanog pristupa institucija i organizacija uključenih u sprečavanju i sankcionisanju negativnih pojava u sportu, razvoju i održivosti ljudskih i infrastrukturnih kapaciteta u tom pogledu, kao i unapređenje dijaloga sa navijačima, sportskom javnošću i zajednicom uopšte.

KAPITULLI III **RENDI DHE SIGURIA NË NGJARJET SPORTIVE**	**CHAPTER III** **SAFETY AND SECURITY AT SPORTS EVENTS**	**POGLAVLJE III** **RED I BEZBEDNOST NA SPORTSKIM DOGAĐAJIMA**
Neni 7 **Përgjegjësit për rendin dhe sigurinë**	**Article 7** **Persons responsible for safety and security**	**Član 7** **Odgovorni za red i bezbednost**
1. Organizatori i ngjarjes sportive (në tekstin e mëtejmë: organizatori) është përgjegjësi kryesor për ndërmarrjen e masave të rendit dhe sigurisë në përputhje me planet e sigurisë dhe ato operative të miratuara.	1. The organizer of the sports event (hereinafter: the organizer) shall be primarily responsible for undertaking safety and security measures in accordance with the approved security plans and operational plans.	1. Organizator sportskog događaja (u daljem tekstu: organizator) glavni je odgovoran za preduzimanje mera reda i bezbednosti u skladu sa usvojenim bezbednosnim i operativnim planovima.
2. Për këtë qëllim, organizatori respektivisht Zyrtari për Rend dhe Siguri zhvillon Planin e Rendit dhe Sigurisë dhe siguron numër të mjaftueshëm të personelit që kujdeset për rendin dhe sigurinë në ngjarje sportive, sigurimin privat, kujdestarët, vullnetarët dhe kontrolluesit e biletave, nëse zbatohet.	2. For this purpose, the organizer respectively the Safety and Security Officer shall develop the Safety and Security Plan and ensure an adequate number of personnel to maintain safety and security at sports events, including private security, stewards, volunteers and ticket inspectors, if applicable.	2. U tu svrhu, organizator, odnosno službenik za red i bezbednost izrađuje Plan reda i bezbednosti i obezbeđuje dovoljan broj osoblja koje brine o redu i bezbednosti na sportskim događajima, privatno obezbeđenje, redare, volontere i kontrolore ulaznica, ako je primenjivo.
3. Numri i saktë i pjesëtarëve të sigurimit privat dhe kujdestarëve përcaktohet nga organizatori i ngjarjes sportive dhe Zyrtari për Rend dhe Siguri në bashkëpunim me	3. The exact number of private security personel and stewards is determined by the organizer of the sports event and the Safety and Security Officer in cooperation with	

Policinë e Kosovës, duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut të ngjarjes sportive.	the Kosovo Police, based on the risk assessment of the sports event.	3. Tačan broj članova privatnog obezbeđenja i redara utvrđuje organizator sportskog događaja i Službenik za red i bezbednost u saradnji sa Kosovskom policijom, na osnovu procene rizika sportskog događaja.
4. Në çdo kohë kur rrezikohet siguria në një ngjarje sportive dhe për menaxhimin e saj nuk mjaftojnë kapacitetet e brendshme, organizatori mund të kërkojë mbështetje nga Policia e Kosovës për të siguruar rendin publik brenda objektit apo infrastrukturës sportive dhe perimetrit të sigurisë.	4. Whenever the security at a sports event is at risk and internal capacities are not sufficient for its management, the organizer may request support from the Kosovo Police to ensure public order within the sports facility or infrastructure and the security perimeter.	4. U svakom trenutku kada se bezbednost u sportskom događaju ugrožava i za njeno upravljanje nisu dovoljni unutrašnji kapaciteti, organizator može zahtevati podršku od Policije Kosova da obezbedi javni red unutar sportskog objekta i bezbednosnog perimetra.
5. Në zbatimi të këtij Neni, në ngjarjet sportive me rrezik të lartë, organizatori njofton Këshillin dhe mban takim me zyrtarët e Policisë së Kosovës, përfaqësuesit e shërbimeve përkatëse shëndetësore dhe të shërbimeve zjarrfikëse, përfaqësuesit nga komuna ku zhvillohet ngjarja, përfaqësuesit e federatës përkatëse, përfaqësuesit e tifozëve, si dhe përfaqësuesit e komunitetit për të planifikuar masat kryesore organizative.	5. For the implementation of this article, at high-risk sports events, the organizer shall hold a meeting with the Sports Council, Kosovo Police officials, representatives of relevant health services and fire services, representatives from the municipality where the event takes place, representatives of the relevant federation, fan representatives, as well as community representatives to plan the key organizational measures.	5. U sprovođenju ovog člana, u sportskim događajima visokog rizika, organizator obaveštava Savet i održava sastanak sa zvaničnicima Kosovske policije, predstavnicima nadležnih zdravstvenih i vatrogasnih službi, predstavnicima opštine u kojoj se događaj održava, predstavnicima odgovarajuće federacije, predstavnici navijača, kao i predstavnici zajednice da planiraju glavne organizacione mere.
6. Shërbimet private të sigurisë, të kontraktuara sipas këtij neni, duhet të kenë leje të vlefshme përkatëse të përcaktuar me ligjin përkatës për shërbimet private të sigurisë.	6. Private security services, contracted according to this Article, shall have the relevant permit in accordance with the law on private security services.	6. Privatne službe bezbednosti, ugovorene prema ovom članu, moraju imati važeću odgovarajuću dozvolu definisanu

		relevantnim zakonom za usluge privatnog obezbeđenja.
Neni 8 **Kërkesat e rendit dhe sigurisë**	**Article 8** **Safety and security requirements**	**Član 8** **Zahtevi reda i bezbednosti**
1. Ngjarjet sportive zhvillohen vetëm në objektin apo infrastrukturën e destinuar sportive që plotëson kërkesat e rendit dhe sigurisë dhe standardet tjera teknike sipas legjislacionit në fuqi.	1. Sports events shall take place only in designated sports facilities that meet the requirements for safety and security and other technical standards according to the legislation in force.	1. Sportski događaji se odvijaju samo u namenjenom sportskom objektu ili infrastrukturi koji ispunjava zahteve reda i bezbednosti i druge tehničke standarde prema zakonodavstvu na snazi.
2. Çdo objekt sportiv pajiset me kamera të sigurisë, të cilat mundësojnë mbikëqyrjen e vazhdueshme vizuale të objektit, përfshirë perimetrin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe zërin e ambientit, duke mundësuar kështu mbrojtjen e personave, objektit dhe pajisjeve përkatëse. Çdo ngjarje sportive profesionale regjistrohet nga videokamerat dhe regjistrimet mbahen për periudhën e caktuar kohore sipas legjislacionit përkatës në fuqi.	2. Every sports facility shall be equipped with security cameras, which enable the visual surveillance of the facility, including the internal and external perimeter, as well as the ambient sound, thus ensuring the protection of persons, the facility and the relevant equipment. Every professional sports event shall be recorded by video cameras and the recordings shall be kept for a specified period of time according to the relevant legislation in force.	2. Svaki sportski objekat je opremljen sigurnosnim kamerama, koje omogućavaju kontinuiran vizuelni nadzor objekta, uključujući unutrašnji i spoljašnji perimetar, kao i zvuk ambijenta, omogućavajući tako zaštitu lica, objekta i odgovarajućih oprema. Svaki profesionalni sportski događaj se snima video kamerama i snimci se čuvaju za određeni vremenski period prema zakonodavstvu na snazi.
3. Objektet sportive në të cilat zhvillohen ngjarjet sportive kanë ulëset individuale të përcaktuara për shikuesit sipas numrave.	3. Sports facilities hosting sports events shall have designated individual seats for spectators according to assigned numbers.	
4. Organizatori i ngjarjes sportive i njofton shikuesit dhe pjesëmarrësit në ngjarjen sportive për parkingun publik ose privat në distancë të arsyeshme të objektit	4. The organizer of the sports event shall inform spectators and participants about public or private parking within a reasonable distance from the sports	3. Sportski objekti u kojima se odvijaju sportski događaji imaju pojedinačna sedišta utvrđena za gledaoce prema brojevima.

sportiv, që të mundësojë arritjen dhe largimin e përshtatshëm dhe të sigurtë të shikuesve. 5. Në rast të dëmtimit të objektit sportiv për shkak të ngjarjeve të dhunshme, përdorimi i atij objekti për zhvillimin e ngjarjeve sportive mund të pezullohet deri në rinovimet e nevojshme, për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e rendit dhe sigurisë. 6. Paralajmërimi i ngjarjes sportive jashtë afateve kohore ligjore rezulton me pezullimin e ngjarjes sportive. 7. Organizatori i ngjarjes sportive detyrohet që për ngjarjet sportive të planifikuara të dërgojë të gjitha informacionet e përgjithshme tek organet e rendit sipas kërkesave të tyre. 8. Organizatori i ngjarjes sportive informon shikuesit para mbajtjes së ngjarjes sportive për rregullat e sjelljes dhe sanksionet përkatëse. **Neni 9** **Certifikimi i rendit dhe sigurisë të objekteve**	facility, to enable the convenient and safe arrival and departure of spectators. 5. In case of damage to the sports facility due to violent incidents, the use of that facility for hosting sports events may be suspended until necessary renovations are made to ensure compliance with safety and security requirements. 6. Announcement of the sports event outside legal timeframes shall result in the suspension of the sports event. 7. The organizer of the sports event is required to submit all general information about planned sports events to the law enforcement authorities as per their requirements. 8. The organizer of the sports event shall inform spectators prior to the sports event about the rules of conduct and the relevant sanctions. **Article 9** **Certification of safety and security for sports facilities**	4. Organizator sportskog događaja obaveštava gledaoce i učesnike u sportski događaj o javnom ili privatnom parkingu na razumnoj udaljenosti od sportskog objekta, kako bi se omogućio pogodan bezbedan dolazak i odlazak gledalaca. 5. U slučaju oštećenja sportskog objekta usled nasilnih događaja, korišćenje tog objekta za odvijanje sportskih događaja može se obustaviti do neophodnih renoviranja, da bi se obezbedila usklađenost sa zahtevima reda i bezbednosti. 6. Obaveštenje o sportskom događaju van zakonskih vremenskih rokova dovodi do suspenzije sportskog događaja. 7. Organizator sportske priredbe je dužan da sve opšte informacije dostavi organima za sprovođenje zakona po njihovim zahtevima za planirane sportske događaje. 8. Organizator sportske priredbe obaveštava gledaoce pre održavanja sportske priredbe o pravilima ponašanja i odgovarajućim sankcijama.

1. Vlerësimi i plotësimit të kërkesave të rendit dhe sigurisë për objektet sportive bëhet nga federatat përkatëse sipas rregullave të tyre të brendshme. 2. Një kopje e çdo certifikate, sipas këtij neni, i dërgohet Policisë së Kosovës, shërbimeve ambulatore shëndetësore dhe shërbimeve zjarrfikëse, komunës ku ndodhet objekti sportiv, si dhe Këshillit.	1. The assessment of the fulfillment of order and security requirements for sports facilities shall be conducted by the relevant federations according to their internal rules. 2. A copy of each certificate, as per this Article, is sent to the Kosovo Police, the health ambulance services, the fire services, the municipality where the sports facility is located, and the Council.	**Član 9** **Sertifikovanje reda i bezbednosti objekata** 1. Procena ispunjenja zahteva reda i bezbednosti za sportske objekte se vrši od odgovarajuće federacije prema njihovim unutrašnjim pravilima. 2. Kopija svakog sertifikata, prema ovom članu, šalje se Kosovskoj policiji, ambulante zdravstvene službe i vatrogasne službe, opštine u kojoj se nalazi sportski objekat, kao i Saveta.
Neni 10 **Vlerësimi i rrezikut të ngjarjes sportive** 1. Para çdo ngjarjeje sportive profesionale bëhet vlerësimi i rrezikut të ngjarjes sportive. 2. Vlerësimi i rrezikut bëhet nga organizatori i ngjarjes sportive, gjegjësisht Zyrtari për Rend dhe Siguri, në konsultim me Policinë e Kosovës dhe Këshillin për Sport, si dhe institucionet tjera përkatëse, së paku shtatë (7) ditë para zhvillimit të ngjarjes sportive. 3. Ngjarja sportive përcaktohet me rrezik të lartë nëse, për shkak të kushteve dhe rrethanave në të cilat zhvillohet, ajo paraqet rrezik për sigurinë e të	**Article 10** **Risk assessment of the sports event** 1. Prior to any professional sports event, a risk assessment of the sports event shall be conducted. 2. The risk assessment is carried out by the sports event organizer, specifically the Safety and Security Officer, in consultation with the Kosovo Police and the Sports Council, as well as other relevant institutions, at least seven (7) days before the sports event takes place. 3. A sports event is deemed to be of high risk if, due to the conditions and circumstances in which it takes place, it poses a risk to the safety of those present in	**Član 10** **Procena rizika sportskog događaja** 1. Pre svakog profesionalnog sportskog događaja vrši se procena rizika sportskog događaja. 2. Procenu rizika vrši organizator sportskog događaja, odnosno Službenik za red i bezbednost, u konsultaciji sa Kosovskom policijom i Savetom za sport, kao i drugim relevantnim institucijama, najmanje sedam (7) dana pre sportskog događaja.

pranishmëve apo pjesëmarrësve në ngjarjen sportive, qytetarëve të tjerë, si dhe për pronën private dhe publike. 4. Për ngjarjen sportive që përcaktohet me rrezikshmëri të lartë, organizatori njofton Policinë e Kosovës, Këshillin për Sport, komunën përkatëse dhe autoritetet e tjera përkatëse që ofrojnë shërbime shëndetësore dhe emergjente, duke përfshirë shërbimet zjarrfikëse. 5. Vlerësimi i ngjarjes sportive me rrezik të lartë mund të kërkojë ndërmarrjen e masave shtesë të rendit dhe sigurisë, duke përfshirë ndalimin e hyrjes së një pjese apo të të gjithë tifozëve ose shikuesve në objektin sportiv, si dhe kufizime të tjera eventuale që kanë të bëjnë me rendin dhe sigurinë. 6. Pavarësisht vlerësimit të bërë nga organizatori i ngjarjes sportive, Policia e Kosovës, bazuar në vlerësimet e veta për sigurinë, ka të drejtë të shpallë ekskluzivisht një ngjarje sportive me rrezikshmëri të lartë. Vendimi i Policisë arsyetohet dhe për këtë njoftohet menjëherë organizatori i ngjarjes sportive, i cili njofton autoritetet përkatëse sipas paragrafit 4.	the facility, those who participate in the sports event, other citizens, as well as endangers private and public property. 4. For the sports event that is deemed to be of high risk, the organizer shall notify the Kosovo Police, the Sports Council, the relevant municipalities and other relevant authorities providing health and emergency services, including fire services. 5. The high-risk assessment of the sports event may require the undertaking of additional safety and security measures such as prohibiting entry for some or all fans or spectators into the sports facility, as well as other possible restrictions related to safety and security. 6. Regardless of the assessment made by the organizer of the sports event, the Kosovo Police, based on its security assessments, shall have the right to exclusively announce a high-risk sports event. The decision of the Police is justified and the organizer of the sports event must be promptly notified, who shall then notify the relevant authorities according to paragraph 4.	3. Sportski događaj se utvrđuje visokim rizikom ako zbog uslova i okolnosti u kojima se održava predstavlja rizik po bezbednost prisutnih ili učesnika u sportski događaj, drugih građana, kao i za privatnu i javnu imovinu. 4. Za sportski događaj koji se utvrđuje kao sa visokim rizikom, organizator obaveštava Policiju Kosova, Savet za sport, odgovarajuću opštinu i druge odgovarajuće autoritete koji pružaju zdravstvene i hitne usluge, uključujući vatrogasne usluge. 5. Procena sportskog događaja sa visokim rizikom može zahtevati preduzimanje dodatnih mera reda i bezbednosti, uključujući zabranu ulaska dela ili svih navijača ili gledaoca u sportski objekat, kao i druga eventualna ograničenja koja se odnose na red i bezbednost. 6. Bez obzira na izvršenu procenu od organizatora sportskog događaja, Kosovska policija, na osnovu sopstvenih bezbednosnih procena, ima pravo da ekskluzivno najavi sportski događaj visokog rizika. Odluka Policije se opravdava i o tome se odmah obaveštava organizator sportskog događaja, koji

		obaveštava nadležne organe prema stavu 4.
Neni 11 **Inspektimi i infrastrukturës dhe objekteve sportive**	**Article 11** **Inspection of infrastructure and sports facilities**	**Član 11** **Inspekcija infrastrukture i sportskih objekata**
1. Inspektorati i Sportit inspekton infrastrukturën dhe objektet sportive për të vlerësuar dokumentacionin përkatës dhe plotësimin e kërkesave të rendit dhe sigurisë.	1. The Sports Inspectorate shall inspect the infrastructure and sports facilities to assess the relevant documentation and the fulfillment of safety and security requirements.	1. Inspektorat za sport vrši inspekciju sportske infrastrukture i objekata da bi procenio odgovarajuću dokumentaciju i ispunjavanje zahteva reda i bezbednosti.
2. Zbatimi i procedurës së inspektimit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimet.	2. The implementation of the inspection procedure is done in accordance with the legislation in force on inspections.	2. Sprovođenje postupka inspekcije se vrši u skladu sa zakonodavstvom na snazi o inspekcijama.
